# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-432711**
VERSIONI

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | “S’të kam thënë të dua”, Indri përballet me Vanesën, zbulojnë bisedat pas daljes nga Ferma VIP – Vizion Plus |
| ADRESA | `https://www.vizionplus.tv/ste-kam-thene-te-dua-indri-perballet-me-vanesen-zbulojne-bisedat-pas-daljes-nga-ferma-vip/` |
| BURIMI | vizionplus.tv |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 9 shtator 2026, 09:21:46 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 22 qershor 2026, 20:26:51 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `4e4d60418fa5baf7d965fb4cb3462a941afbdbfa70eb8430dc7ac10afad57517` |
| TEKSTI | `4c65ee434b129a98c4558075b9125402a06a28a738a75b2c4a7f39de6ee0301e` |
| PAMJA | `6f42b581f6a4023b3b7a7ca38a08c639df6f8d5454bc3f8c0e4fb0afa912a762` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `dd962bba09554742d38ee68269ccfc3b8fd8eb46bb71207a37ad0e77bc63165f` |
| E MËPARSHMJA | `5fc9f921cd484310e5714f62c57ac59284eebcf02a472f66dc06308935a0f323` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/dd962bba09554742d38ee68269ccfc3b8fd8eb46bb71207a37ad0e77bc63165f`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Indrit, të cilët sqaruan publikisht raportin e tyre pas përfundimit të spektaklit.

Vanesa u shpreh e zhgënjyer nga sjellja e Indrit pas daljes nga ferma, duke deklaruar se kishte investuar maksimalisht në marrëdhënien e tyre, ndërsa sipas saj ai e harroi gjithçka sapo ajo u eliminua.

Nga ana tjetër, Indri mohoi se kishte luajtur me ndjenjat e saj dhe këmbënguli se çdo gjë që kishte thënë brenda fermës ishte e sinqertë.

Indri pranoi se kishte gabuar me mënyrën se si kishte vepruar pas largimit të Vanesës, por mohoi që Klevisa të kishte qenë arsyeja e krisjes së raportit të tyre.

**Pjesë nga biseda:**

**Florian Agalliu:** Pasi u eliminove, si e le marrëdhënien?

**Vanesa:** Ne ishim shumë, shumë mirë. Përgjatë gjithë javës së fundit unë i jam dhënë 150% Indrit dhe deri në ditën e fundit meraku im ka qenë si ishte ai. Kur kam dalë, kam lënë amanet rrobat dhe fizikën e Indrit. Pesë minuta që dola, pastaj ishte kështu si një pluhur, u harrua çdo gjë që kishte ndodhur këtu brenda.

**Florian Agalliu:** Ju keni komunikuar gjatë kësaj kohe që keni qenë jashtë?

**Vanesa:** Kemi pasur një bisedë te after party. Një bisedë shumë të shkurtër, pesë minuta. Në ato pesë minuta vërtetova edhe njëherë atë që

5 “Dhëmballa e pjekurisë mund të shkaktojë tumor”, kirurgu oral: Kur...

NEWSLETTER
**Përmbledhja e ditës në e-mail**
emaili juaj
Abonohu

kisha krijuar, ishte shumë i ftohtë në logjikën, në atë që thoshte. Kuptova që s'kishte pasur pikë ndjenje.

**Indri:** Unë e kuptoj Vanesën, më vjen shumë keq. Unë të gjitha gjërat që t'i kam thënë ty, i kam thënë se i kam ndjerë vërtet. Nuk ka qenë strategji.

**Vanesa:** Ka qenë.

**Indri:** Unë nuk e kam fuqinë të të bëj ty të më besosh. Por unë po ta them në sy, letrën e kam shkruar unë me vullnetin tim.

**Vanesa:** Bravo, urime.

**Indri:** Unë kam pasur vërtet një pëlqim të madh për ty që në ditën 1, 2. Më ke pëlqyer shumë për vajzën që je, për artisten që je, për shpirtin e pastër që mendoj se e ke. Ndodhi çfarë ndodhi… Ti je viktimë e atij problemi që unë kam pasur, e atij momenti. Unë shumë, shumë herë të kam thënë ta marrim me qetësi, hap pas hapi. Ti s'e ke marrë me qetësi.

**Vanesa:** Më thuaj kur s'e kam marrë unë me qetësi?

**Indri:** Kemi pasur një disnivel.

**Vanesa:** Pse s'ma ke thënë brenda, por prite të dilja jashtë?

**Indri:** Në momentin që ti më thua "të dua", "jam e përfshirë"… në momentin që unë s'të përgjigjem "të dua", por them ta marrim me qetësi…

**Vanesa:** Jo, s'ma ke thënë.

**Indri:** Ka qenë një marrëdhënie njohjeje.

**Vanesa:** Nëse të pyesin: "Vanesa Sono çfarë e ke pasur?", çfarë do thuash ti? Do thuash e kam pasur shoqe? Çfarë kemi qenë ne të dy?

**Indri:** Të dashur s'kemi qenë. Ajo që të kam dhënë unë ty ka qenë komplet prej shpirtit tim, të tëra momentet e bukura.

**Vanesa:** Ke dalë dhe ke thënë s'kam qenë i dashuruar. Si ke dhënë dashuri kur s'ke qenë i dashuruar?

**Indri:** Po, faji im është që s'kam rënë në dashuri me ty, o Vanesa?

**Vanesa:** Pika jote e fortë në lojë ishin marrëdhëniet romantike. Dhe the: "Marrëdhënia romantike iku, çfarë të bëj unë tani?". Po prit se kjo vajza, Klevisa, erdhi, ja ta shtyj deri në finale.

**Indri:** Klevisa s'ka lidhje me ndarjen tonë. Bëra gabim, shumë gabim që shpreha diçka të sinqertë për Klevisën.

**Vanesa:** Mua gjëja që më bezdisi më tepër se ndërprerja e marrëdhënies është, nga ana njerëzore, një seri gjërash që ti bëre. Vjen Klevisa, pas pesë minutash që unë isha larguar, shkon merr Klevisën, harrove dhe patericën. Madje, në një moment the: "Shpëtova nga skemat". Nga cilat skema?

/vizionplus.tv

#FermaVIP #indri #vanesa #VizionPlus

**Redaksia Web**
Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.
Të gjithë artikujt

## Vazhdo të lexosh

FERMA VIP 3
**Kur e kupton që një djalë të do vërtet?...**
Redaksia Web · 11 Sht

BOTA
**Trump i lumtur që princ Harry dhe...**
Ana Miha · 3 Sht

SHOWBIZ
**Incidenti i frikshëm gjatë çmontimit të...**
Ana Miha · 2 Sht



© 2026 Vizion Plus · Të gjitha të drejtat e rezervuara



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.